



Porto-Romano, Prill 2009

HISTORIK I SHOQERISE

ROMANO-PORT

Romano-Port është një shoqëri aksionere. Ajo është themeluar me dt. 28.10.2003 dhe ka si objekt: “Ndertimin dhe Shfrytëzimin e Portit të Shkarkimit të Naftes dhe nënprodukteve të saj si dhe L.P.G.” në Porto-Romano, Durrës.

Romano-Port ka ndërtuar portin 6.5 km në veri të qytetit të Durrësit.

Vendi i montimit të objektit është vendosur brenda sheshit ndërtimit miratuar; me sipërfaqe 6000 m² tokë dhe 42.000 m² në dete.

Vendi i projektit të Romano-Port



Terminali është dizenuar nga NEDECO, një konsorcium kompanish konsultente hollandeze. Konsulenti kryesor Witteven + Bos është një kompani me reputacion ndërkombëtar.

Qellimi i objektit

Qellimi i këtij objekti konsiston në krijimin e një ambjenti të përshtatshëm konstruktiv dhe teknologjik për të mundësuar ankorimin e anijeve cisterne për shkarkimin e tyre nëpërmjet tubacioneve në depozitat përkatëse në tokë të naftes dhe L.P.G.

Funksioni i Objektivit

Teknologjikisht ky proces realizohet nepermjet ketyre elementeve:

Vend ankorimi detar

Nje sistem shkarkimi te produkteve prej anijeve cisterne.

Nje sistem tubacionesh me aksesoret e sigurimit dhe kontrollit te dergimit te produkteve drejt depozitave ne toke.

Impjantet fundore te shperndarjes

Nje sistem elektronik komandimi.

Terminali do te perballoje anijet me ngarkesa te gazit te lengshem me kapacitet **9000 ton dhe anije cisterne per naften me kapacitet deri 20.000 ton.**

Kapaciteti shkarkues i paisjeve eshte :

4000 ton per L.P.G / 24 ore

9000 ton nafte (gazoil) 24 /ore

Kontrata e koncesionit dhe lejet

Ka nje ligj te Republikes se Shqiperise me nr 9298 dt 28.10.2004 per "Ratifikimin e Marreveshjes se Kocensionit te formes **BOT** (ndertim, shfrytezim, treansferim) per ndertimin dhe shfrytezimin e pontilit te naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre ne zonen bregdetare te Porto Romanos,Durres"

Kjo marreveshje eshte nenshkruar nermjet Keshillit te Ministrave te Republikes Shqiperise dhe shoqerise "Romano Port" Ky ligj eshte botuar ne fletoren zyrtare nr 88 te muajit dhjetor te vitit 2004.

Ka nje leje mjedisore per veprimtari qe kane ndikim ne mjedis me nr 312 prot te leshuar me dt 07.12.2005 nga ministria perkatese.

Me ligjin nr 9578 dt 11.07.2006 jane ratifikuar ndryshimet ne marrveshjen e kocensionit miratuar me pare, botuar ne fletoren zyrtare me nr 81 te muajit gusht te vitit 2006.

Ka nje vendim te K.RR. T.SH. me nr 3 dt 01.06.2006 per "Miratimin e Lejes Ndertimit per Pontilin e Shkarkimit te Naftes dhe nenprodukteve te saj si dhe gazit te lengshem ne Porto Romano, Durres per shoqerine "Romano Port"

Ka nje " Certifikate per respektimin e kushteve te sigurise ne pune te paisjeve nen presion"leshuar nga Inspektoriati Qendror Teknik.

Ka nje "Akt Teknik" Per Lejimin e Aktivitetit dhe Shfrytezimit te Objektivit" me nr P-8/2 DT 20.01.2009 leshuar nga Drejtoria e PMNZSH Republikes.

Ka nje urdher per "Miratimin e Planit te Sigurise Portit" ne Porto Romano me nr 19 dt 12.02.2009 miratuar nga Ministri i Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Ka nje Vendim te Keshillit te Ministrave te Republikes Shqiperise per " Shpalljen, Kategorizimin dhe emerimin e portit ne Porto Romano si port i hapur per trafik nderkombetar " i dates 25.03.2009. (ende nuk eshte botuar ne fletoren zyrtare)

Shoqeria "Romano Port" ka pregatitur rregullore ne te cilen eshte parashiku struktura organizative, organet drejtuse si dhe forca e sigurise portuale.

Me anen e kesaj rregullorje eshte organizuar dhe funksionon aktiviteti i **sherbimit, menaxhimit dhe i sigurise** ne portin e shkarkimit lendeve djegese ne Porto Romano, Durres.

Forca e sigurise portuale ushtron aktivitetin e saj sipas dispozitave te ligjit 9281 dt 23.09.2004 "Per sigurine ne Anije e Porte" per te siguruar e mbrojtur jeten, pronen dhe shmangjen e rrezikut ndaj veprimeve kriminale.